



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo-Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Legjislatura V**

Sesioni pranveror

Komisioni për Legjislacion, Mandate,

Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen

e Agjencisë Kundër Korrupsionit

Mbledhja nr. 69

Prishtinë, më 16.06.2016, në orën 17:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla S 2

**PROCESVERBAL**

**Në mbledhje morën pjesë:** Albulena Haxhiu, Selviqe Halimi, Agim Aliu, Danush Ademi, Nezir Çoçaj, Armend Zemaj, Agim Ademaj, Doruntine Maloku dhe Milena Miliçeviq.

**Munguan:** Donika Kadaj-Bujupi dhe Valdete Bajrami.

**Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë:** Adem Gashi-US Embassy; Dona Lluka-RTV-Dukagjini; Sanije Berisha- OSBE; Agnesa Haxhiu-KDI; Blerta Bejtullahu, EUSR/EV Office; Besnik Tahiri-Klan Kosova dhe Albert Ahmeti- Zëri.

**Nga Stafi i Komisionit:** Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

**Mbledhjen e kryesoi,** Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit.

**Rendi i ditës:**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-102 për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës;
4. Të ndryshme.

## **1. Miratimi i rendit të ditës**

*Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.*

## **2. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-102 për ratifikimin e marrëveshjes ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbi misionin e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Kosovë**

**Kryesuesja** në fjalën e saj në cilësinë e kryetares së Komisionit për Legjislacion dhe si përfaqësuese e grupit Parlamentar Vetëvendosje kishte vërejtje për Misionin e EULEX-it në Republikën e Kosovës. Në vazhdim tha se nuk është e pranueshme mënyra se si janë proceduar këto projektligje. Ajo e njoftoi Komisionin se të premten Qeveria ka proceduar për Kuvend dy projektligje të tjera nga këto që po shqyrtohen dhe pa u tërhequr ato projektligje sillen projektligje të tjera që kanë të bëjnë me misionin e Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Kosovë. Më pas deputetja Haxhiu shtoi se nëse Qeveria procedon diçka në Kuvend është detyrim që më pas përmes procedurave parlamentare të tërhiqet nga ato, por në këtë rast nuk janë ndjekur këto procedura dhe gjithashtu duhet të ketë një përgjegjësi pse ka ndodhur kjo katrahurë e procedurave parlamentare. Ndërsa vërejtja tjetër kishte të bënte me shqyrtimin e përshpejtuar të këtyre projektligjeve, kur dihet se Qeveria ka pasur dijeni se EULEX-it do t'i përfundojë mandati më 15 qershor dhe nëse ka qenë plani për vazhdimin e mandatit, deputetëve ka qenë dashur qysh moti t'u procedohen këto projektligje, sepse sa herë që diskutohet për EULEX-in bëhen procedura të tilla, kjo është arsyeja që Lëvizja Vetëvendosje nuk e ka mbështetur sot në Kuvend. Të gjithë e dimë se ky mision është instaluar që të luftojë krimin dhe korrupsionin në Kosovë, ndërsa zyrtarët e këtij misioni janë të përfshirë në afëra korruptuese dhe asnjëherë nuk është dhënë përgjegjësi për skandalet që janë paraqitur edhe në media për këtë çështje, shtoi znj. Haxhiu.

Deputetja Haxhiu tha se meqë EULEX-i ka të drejtën të merret me raste të reja atëherë shtrohet pyetja se cilat janë ato raste të jashtëzakonshme dhe nga kush vlerësohet ajo jashtëzakonshmëri, sepse kështu si janë lënë këto dispozita natyrisht që do të ketë edhe probleme, theksoi Albulena Haxhiu. Edhe në Komision edhe në seancë plenare Lëvizja Vetëvendosje do ta kundërshtojë vazhdimin e mandatit të këtij misioni.

*Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se me tetë vota për dhe një votë kundër(Albulena Haxhiu), Komisioni nxori këtë;*

## **R e k o m a n d i m**

*Të miratohet Projektligji nr. 05/L-102 për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërkombëtare në mes të Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian për Misionin e Bashkimit Evropian për sundim të Ligjit në Kosovë.*

## **3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundimin e ligjit në Republikën e Kosovës**

**Kryesuesja** në fjalën e saj sqaroi se ky projektligj ka për qëllim ndryshimin e tri ligjeve; Ligji për Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës, Ligji mbi Kompetencat për Zgjedhjen e Lëndëve dhe Caktimin e Lëndëve të Gjyqtarëve të ndryshuar me ligjin 04/L-273 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e Misionit të Bashkimit Evropian dhe ligji 04/L-033 për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit të ndryshuar me ligjin 04/L-273, për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me mandatin e Misionit Evropian për Sundimin e Ligjit në Republikën e Kosovë.

*Meqë nuk kishe diskutime të tjera, kryesuesja konstatoi se me tetë vota për dhe një votë kundër (Albulena Haxhiu), Komisioni nxori këtë;*

### **R e k o m a n d i m**

Të miratohet, në parim, Projektligji nr. 05/L-103 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që ndërlidhen me mandatin e misionit të Bashkimit Evropian për sundim të ligjit në Republikën e Kosovës

Mbledhja përfundoi në orën 17:10.

E përgatiti:

Stafi Mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

---

**Albulena Haxhiu**